

VENDIM
“Për sekuestrimin e të dhënave bankare”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

MANJOLA BEJLERI - Gjyqtare

Asistuar nga sekretare **Dorit Myftiu**, sot me **dt.22.11.2014** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale me Nr.1638 Akti, që i përket:

KËRKUES: **Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e përfaqësuar nga Prokurore **Antoneta Sevdari**.

OBJEKTI: Sekuestrimi i të dhënave bankare.

BAZA LIGJORE: Neni 208, 210 të K.Pr.Penale.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata pasi shqyrtoi aktet, bisedoi çështjen, administroi provat dhe mori pretendimin e fundit të prokurores e cila kërkoi pranimin e kërkesës,

VËREN:

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën për sekuestrimin e të dhënave bankare për personin juridik Shoqëria “Kalivaç Green Energy” sh.p.k., bazuar në nenin 208 e 210 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin penal Nr.1564, të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Nga aktet e hetimit paraprak rezulton se ky procedim penal është rregjistruar mbi bazën e materialeve të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat rezulton se ndërmjet shoqërive «Kalivaç Green Energy» sh.p.k.; «Cable System» sh.p.k.; «400 KV» sh.p.k.; «Energji» sh.p.k. ; «Fuqi» sh.p.k.; «Investime të Rinovueshme» sh.p.k. etj., janë kryer transaksione financiare të dyshimta dhe pa llogjikë ekonomike. Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë rezulton se në drejtim të shoqërisë «Kalivaç Green Energy» janë transferuar para nga jashtë vendit, për të cilat ka dyshime se burimi i tyre vjen nga veprimtari të paligjshme kriminale.

Nga hetimet e kryera në këtë procedim penal rezulton se:

Me Vendimin Nr.222, datë 24.05.1997, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar marrëveshjen për ndërtimin e Hidrocentralit të Kalivaçit me Shoqërinë Italiane “BEG” S.p.a. Kjo marrëveshje është ndryshuar me Vendimet Nr. 250, datë 02.11.2000 si dhe Nr.363, datë 06.06.2007 të Këshillit të Ministrave.

Në vendimin e fundit të KM u miratuan ndryshime të reja në Kontratën Konçesionare për ndërtimin e hidrocentralit, duke u legjitimuar pjesëmarrja e një partneri të ri në konçesion dhe pikërisht operatorit ekonomik “Deutche Bank”. Kapitali fillestar i shoqërisë konçesionare sipas marrëveshjes duhet të ishte 15.000.000 Euro. Për këtë arsye, në vitin 2007 Konçesionari “BEG” S.p.a. krijon në Itali Shoqërinë “Hydro Srl”, në të cilën “BEG” S.p.a zotëronte 55% të aksioneve dhe “Deutche Bank” 45% të aksioneve. Gjithashtu, në të njëjtën kohë në Shqipëri u krijua Shoqëria “Kalivaç Green Energy” sh.p.k. me ortak të vetëm Shoqërinë “BEG” S.p.a. Qëllimi i krijimit të shoqërisë ishte kryerja e punimeve në Hidrocentralin e Kalivaçit, si nënkontraktore e shoqërisë konçesionare.

Nga hetimi ka rezultuar se Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, gjatë viteve 2012 dhe 2013 ka ushtruar kontroll mbi zbatimin e marrëveshjes së konçesionit të sipërcituar dhe nga kontrollat e ushtruara, ka rezultuar se gjatë zbatimit të punimeve ka mungesa të theksuara dokumentacioni, nuk ka projekt nuk ka situacione si dhe raporte supervizimi të kryerjes së punimeve. Gjithashtu, dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë konstatuar një sërë parregullsish në punimet dhe dokumentacionin e mbajtur nga shoqëria. Rezultojnë vonesa pa fund të kryerjes së punimeve si dhe rezulton që bilancet financiare janë të pashoqëruara me fatura tatimore dhe situacionet përkatëse të realizimit të punimeve.

Nisur nga të dhënat e sipërcituara krijohen dyshime se qëllimi i vërtetë i shoqërisë “BEG” s.p.a. nuk është ndërtimi i Hidrocentralit të Kalivaçit, por pastrimi i parave, apo kryerja e veprave të tjera kriminale, si ajo e “Mashtimit”. Kjo për arsye, se edhe pas 17 vjetësh nga marrëveshja e parë konçesionare, punimet në Hidrocentralin e Kalivaçit jo vetëm që nuk kanë përfunduar, por ato janë ende në faza fillestare. Ky dyshim mbështetet edhe nga fakti se në drejtim të Shoqërisë “Kalivaç Green Energy” sh.p.k. si dhe të shoqërive nënkontraktore të saj “Cable System” sh.p.k. dhe “Energy” sh.p.k. etj, kanë ardhur me transfertë ndërkombëtare rreth 80.000.000 Euro me qëllim kryerjen e punimeve në HEC-in Kalivaç, ndërkohë që 50.000.000 Euro, rezulton të jenë transferuar përsëri jashtë vendit me qëllim “Financim ortaku” dhe “Kthim investimi”. Gjithashtu, në favor të këtij dyshimi është dhe fakti se paratë e transferuara

kalojnë nga njëra shoqëri shqiptare në tjetrën, «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. «Cable System» sh.p.k. «400 KV» sh.p.k, «Energji» sh.p.k. etj. mbi baza kontaktash huaje, pa asnjë llogjikë ekonomike. Nga të dhënat e marra nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit rezulton se të gjitha shoqëritë e krijuara në Shqipëri kontrollohen nga Grupi “Beccheti”. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit rezulton se Shoqëria “BEG” s.p.a. ka si ortakë, ndër të tjerë, edhe shtetasin Manlio Cerroni, i cili sipas burimeve të hapura të informacionit rezulton të jete nën hetim në shtetin Italian për veprat penale të “Trafikimit të paligjshëm të mbetjeve urbane” dhe “Mashtrimit”.

Nga hetimi ka rezultuar se nga llogaritë e Shoqërisë “Kalivaç Green Energy” në bankat e ndodhura në Austri-Vjenë janë dërguar rreth 4.800.000 Euro në llogaritë e po kësaj shoqërie në Shqipëri.

Për sa më sipër, bazuar në nenet 509/1 dhe 510 të Kodit të Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe në Konventën Europiane «Për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale» dt.20.04.1957, nenet 14 e vijues, në interesin e këtij hetimi, me Shkresën Nr.11044 Prot., dt.29.07.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, iu është kërkuar autoriteteve gjyqësore kompetente të Shtetit të Austrisë të dërgojë të dhënat e poshtëshënuara:

1. Cili është burimi i krijimit të të ardhurave, të parave të transferuara nga llogaritë e Shoqërisë «Kalivaç Green Energy» në Bankat Austriake sipas sëift-it bashkëlidhur kësaj letërporosie, në drejtim të llogarive të Shoqërisë «Kalivaç Green Energy» në Shtetin Shqiptar?
2. Kush është personi që ka nënshkruar transferimin e këtyre parave? Bashkëlidhur na dërgoni kopje të dokumentacionit të identifikimit dhe të përfaqësimit të shtetasve që kanë përfaqësuar shoqërinë në veprimet bankare.
3. Na informoni për llogaritë e hapura në Austri nga Shoqëria «Kalivaç Green Energy» sh.p.k., gjendjen aktuale të këtyre llogarive si dhe lëvizjet bankare të kryera si dhe burimin e krjimit të të ardhurave në këto llogari nga momenti i krijimit dhe në vazhdim.
4. Gjithashtu, kërkohmë të na informoni edhe për çdo transfertë tjetër të ndryshme nga Sëift-et e sipërcituara të kryer nga Shoqëria «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. si dhe për burimin e krijimit të të ardhurave të këtyre transfertave.
5. A egzistojnë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme rregjistruara në emër të shoqërisë «Kalivaç Green Energy » sh.p.k.? Në rast se

po, kërkojmë të na informoni për vlerën e këtyre pasurive si dhe burimin e të ardhurave me të cilat janë financuar pasuritë.

6. Sekuestrimin e dokumentave në bazë të të cilave është urdhëruar transferimi apo kryerja e veprimeve të ndryshme financiare në llogaritë e Shoqërisë «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. Gjithashtu, kërkojmë kopje të gjithë dokumentacionit bankar (të njehsuar me origjinalin) të dorëzuar nga Shoqëria «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. në bankat Austriake në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave dhe transfertave të sipërcituara.

Me shkresën e tyre të datës 30.09.2014, Autoritetet e Drejtësisë Austriake i kanë kërkuar autoriteteve shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, që për të dërguar të dhënat e sipërcituara, është i domosdoshëm një vendim gjyqësor, i cili të lejojë marjen e këtyre të dhënave.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 208 dhe 210 të Kodit të Procedurës Penale, Prokurorja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar lejimin e sekuestrimit të çdo të dhëne bankare në bankat Austriake, që lidhen me Shoqërinë «Kalivaç Green Energy» sh.p.k., me qëllim që t'i jepen përgjigje çështjeve të sipërshënuara.

Lidhur me sa u kërkua nga Prokuroria, Gjykata vëren se kërkesa e paraqitur prej saj duhet pranuar si e bazuar në prova e në ligj. Në rastin konkret, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural penal për sekuestrimin e të dhënave bankare të kërkuara.

Në nenin 208/1 të K.Pr.Penale parashikohet se:

“Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arësyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.”

Në nenin 210 “Sekuestrimi pranë bankave” të K.Pr.Penale parashikohet se:

“1.Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arësye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.”

Gjykata vëren se në rastin konkret, nga ana e Prokurorisë po hetohet dhe ka nisur procedimi penal Nr.1564, të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Sekuestrimi i të dhënave bankare të kërkuara nga Prokuroria është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve, vërtetimin e fakteve që provojnë

kryerjen e veprës penale, identifikimin e autorit si dhe persona me të cilët ai bashkëpunon.

Bazuar në sa më sipër dhe provat e administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata konkludon se përmbushen kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji procedural shqiptar për sekuestrimin pranë bankave, si edhe nga Konventa Europiane e Varshavës ““Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”” dt.16.05.2005 dhe se kërkesa e Prokurorisë duhet pranuar si e bazuar në ligj e në prova.

PËR KËTO ARËSYE:

Gjykata duke u bazuar në nenet 208 e 210 të K.Pr.Penale të Republikës së Shqipërisë, Konventës Europiane të Varshavës ““Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”” dt.16.05.2005, Konventën Europiane Për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Cështjet Penale dt.20.04.1957 dhe Protokollit të saj shtesë dt.17.03.1997,

VENDOSI:

A) Pranimin e kërkesës.

B) Lejimin e sekuestrimit të të dhënave (dokumentave) bankare për personin juridik Shoqëria “Kalivaç Green Energy” sh.p.k., lidhur me proçedimin penal me Nr.1564, të vitit 2014, që bën fjalë për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 i K.Penal, me qëllim marrjen e të dhënave të poshtëshënuara:

- I. Sekuestrimin e dokumentave në bazë të të cilave është urdhëruar transferimi apo kryerja e veprimeve të ndryshme financiare në llogaritë e Shoqërisë «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. në Bankën e ndodhur në Austri- Raiffeisen Bank International AG, Viena AT, me sëift bankar « » në drejtim të llogarive të kësaj shoqërie në Shtetin Shqiptar, dhe dhënie kopje e të gjithë dokumentacionit bankar (të njehsuar me origjinalin) të dorëzuar nga kjo shoqëri që tregojnë burimin e krijimit të të ardhurave dhe transfertave të sipërcituara.
- II. Dokumentin që tregon se cili është personi që ka nënshkruar transferimin e këtyre parave. Nëse ka bashkëlidhur, të dërgohet

dokumentacioni ose kopje të tij, të identifikimit dhe të përfaqësimit të shtetasve që kanë përfaqësuar shoqërinë në veprimet bankare.

III. Informacion për llogaritë e hapura në Austri nga Shoqëria «Kalivaç Green Energy» sh.p.k., gjendjen aktuale të këtyre llogarive, lëvizjet bankare të kryera si dhe burimin e krjimit të të ardhurave në këto llogari nga momenti i krijimit dhe në vazhdim.

IV. Informacion edhe për çdo transfertë tjetër të ndryshme të kryer nga Shoqëria «Kalivaç Green Energy» sh.p.k. në Bankën e ndodhur në Austri- Raiffeisen Bank International AG, Viena AT, sipas sëift-it «RZBA AT ËË », nëse ka, si dhe për burimin e krjimit të të ardhurave të këtyre transfertave.

V. Dokumentacion nëse ka, për egzistencën e pasurive të luajtëshme dhe të paluajtëshme rregjistruara në emër të Shoqërisë «Kalivaç Green Energy » sh.p.k., si edhe informacion në lidhje me vlerën e këtyre pasurive dhe burimin e të ardhurave me të cilat janë financuar pasuritë.

C) Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë, e cila si autoriteti përkatës të kryejë veprimet e duhura proceduriale për lejimin e ekzekutimit të këtij vendimi në Shtetin e Austrisë.

D) Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve, nga të interesuarit që kanë ardhur në dijeni të këtij vendimi.

U shpall sot me dt. 22.11.2014, Tiranë.

**SEKRETARE
DORIT MYFTIU**

**GJYQTARE
MANJOLA BEJLERI**